

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Naxhis Sharani, procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarit M. Xh., nga fshati P., Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 pika 1.4 të KP-ës, sipas aktakuzës të Prokurorisë themelore në Prizren PP.nr.1469/2014 të datës 17.10.2014, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në praninë e Prokurorit të shtetit në Prizren Musli Gashi, të akuzuarit, dhe të dëmtuarit D. G., me datën 04.12.2015 publikisht morri dhe shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari:**

**M. XH.**, nga i ati I. dhe nëna B. e lindur H., i lindur me datë *data e lindjes...*, në Prizren, tani jeton në fshatin P., Komuna e Prizrenit, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor, i pa martuar, shqiptar, shtetas e Republikës së Kosovës, i gjendjes së mesme ekonomike.

**ËSHTË FAJTOR**

Se me datë 02.06.2014, rreth orës 17,00 minuta, në Prizren, në rrugën ..., i shkakton lëndime trupore dhe përkohësisht ia dëmton shëndetin e të dëmtuarit D. G., në atë mënyrë që deri sa i dëmtuari ishte i ulur në një ulëse të parkut me një vajzë, i njëjti i drejtohet me fjalët “ku je o p... nëne”, fillimisht e godet me grushta e më pastaj me një gur – mjet ky i përshtatshëm për shkaktimin e lëndimit të rëndë trupor ose dëmtimit të rëndë të shëndetit në regjionin e kokës dhe në regjionin e syrit të majtë, me ç ‘rast me këto veprime i shkakton lëndime të lehta trupore, lëndime këto më afër të konstatuara në mendimin e ekspertit mjeko-ligjor, dr. N. U., të dhënë me datë 15.07.2014,

Këso dore ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 të KP-ës.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7,41,49 par.1 pika 1.1,50,51,52,73,74,75, dhe 188 par.2 lidhur me par.1 pika 1.4 të KP-së, të akuzuarit i shqipton:

**DËNIM ME KUSHT**

Vërteton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin prej 2 (dy) viteve nga dita e plotëfuqishëmrisë të këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale,

Obligohet i akuzuari të paguaj shpenzimet e procedurës gjyqësore dhe ate në emër të ekspertizës mjeko ligjore shumë prej 20,00 euro dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor në

shumën prej 20,00 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmrisë të këtij aktgjykimi, nën kërcnim të ekzekutimit të dhunshëm.

I dëmtuari D. (I.) G., nga fshati A., Komuna e Prizrenit, për realizimin e kërkesës pronësoro juridike udhëzohet në kontestin e rregullt civil.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP.nr.1469/2014 të datës 17.10.2014, kundër të akuzuarit M. Xh., nga fshati P., Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 pika 1.4 të KP-ës.

Prokurori i shtetit Musli Gashi në fjalën e tij përfundimtare deklaron: mbes në tërësi pranë aktakuzës PP.nr.1469/2014 të datës 17.10.2014, të parashtruar ndaj të pandehurit M. Xh., nga fshati P., Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 pika 1.4 të KP-së, e tërë kjo ngase në shqyrtimin e sotëm gjyqësor në tërësi u vërtetua gjendja faktike e përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, e kjo nga vet pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit, i cili në mënyrë vullnetare e pranoi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barë, si dhe në bazë të provave tjera që gjenden në shkresat e lëndës. Andaj propozoj gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit, paraprakisht duke i mare për bazë rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese.

I dëmtuari D. G., në fjalën e tij përfundimtare deklaron: që si palë e dëmtuar parashtroj kërkesë pronësoro juridike, për lartësinë e të cilës shumë do të deklarohej në kontestin e rregullt civil.

I akuzuari M. Xh., në fjalën e tij përfundimtare deklaron: e pranoj në tërësi veprën penale e cila më vihet në barë me aktakuzën të ngritur ndaj meje, unë pendohej thellë për veprën e kryer, i kërkoj falje sot publikisht të dëmtuarit D. G., dhe theksoj që nga dita kur ka ndodhur rasti me datë 02.06.2014, e deri më tani më nuk kemi pasur asnjë mosmarrëveshje, me të njëjtin ka pasur raste kur jemi takuar, por nuk jemi përshëndetur, theksoj edhe faktin që shkak i tërë kësaj ka qenë një femër, e cila për mua ka qenë person me të cilën kam pretenduar të kem lidhje serioze, dhe në momentin kur e kam pa të njëjtën në shoqëri me të dëmtuarin, kam reaguuar në atë mënyrë që e kam goditur së pari me grusht, e pastaj edhe e kam hedhur me gurë, dhe të njëjtit janë shkaktuar lëndimet, lëndime këto të cilat janë të konstatuara edhe në raportin mjekësor si dhe në ekspertizë, të cilat janë pjesë përbërëse të shkresave të kësaj lënde. Në fund theksoj, që të cekurat më lart gjykata ti ketë parasysh me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin, pos kësaj i propozoj gjykatës që pranimin e fajësisë, sjelljen time korrekte para gjykatës, bashkë punimin e përgjithshëm me organet gjyqësore që nga fillimi i procedurës, moshën time të re, dhe se kërkim faljen publike sot para gjykatës ndaj të dëmtuarit, konsideroj që të gjitha këto rrethana janë rrethana lehtësuese, të cilat i propozoj gjykatës ti merr parasysh me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin.

Gjykata në shqyrtimin kryesor ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Se me datë 02.06.2014, rreth orës 17,00 minuta, në Prizren, në rrugën ..., i akuzuari, i shkakton lëndime trupore dhe përkohësisht ia dëmton shëndetin e të dëmtuarit D. G., në atë mënyrë që deri sa i dëmtuari ishte i ulur në një ulëse të parkut me një vajzë, i njëjti i drejtohet me fjalët “ku je o p... nëne”, fillimisht e godet me grushta e më pastaj me një gur – mjet ky i përshtatshëm për shkaktimin e lëndimit të rëndë trupor ose dëmtimit të rëndë të shëndetit në regjionin e kokës dhe në regjionin e syrit të majtë, me ç ‘rast me këto veprime i shkakton lëndime të lehta trupore, lëndime këto më afër të konstatuara në mendimin e ekspertit mjekoligjor, dr. N. U., të dhënë me datë 15.07.2014,

Gjykata gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit i cili në shqyrtimin gjyqësor vullnetarisht ka pranuar fajin, për shkak të cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se e akuzuara ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit për veprën penale e cila i vihet në barrë e që pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështetet në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë për të cilat e akuzuara ka qenë e njoftuar me të gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhur në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarës është bërë në pajtim me neni 248 të KPP dhe faktet që përmban aktakuza, në veprimet e të akuzuarës formohen të gjitha elementet e veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 të KP-së, dhe për këtë gjykata të akuzuarën e shpalli fajtores dhe i shqiptoj dënimin me kusht paraprakisht duke e vërtetuar përgjegjësinë e saj penale juridike.

Me rastin e marrjes të vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos gjetur rrethana rënduese, e që si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, sjellja korrekte e tij pas kryerjes së veprës penale, pendimi i thellë i tij, gjer më tani i pa gjykuar, çka nënkupton se nuk kanë ardhur ndesh me rregullat pozitive, në kuptim të dispozitave të nenit 74 gjykata vlerësoi rrethanat personale dhe karakterin e të akuzuarit, moshën e të akuzuarit, bashkëpunimin e përgjithshëm të akuzuarit me gjykatën, pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, shprehja e keqardhjes të akuzuarit për veprën penale të shkaktuar, si dhe sjelljen korrekte të tij gjatë shqyrtimit si dhe pas veprës penale të shkaktuar, andaj gjykata i shqiptoi dënimin me kusht dhe ate dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin prej 2 (dy) viteve nga dita e plotëfuqishëmrisë të këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë të tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 450 dhe 451 të KPP.

Vendimin mbi udhëzimin e të dëmtuarit në kontest të rregullt civil gjykata e bazoi konform nenit 463 par.1 të KPP.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**P.nr.1581/2014 me datë 04.12.2015**

**Procesmbajtësja**  
**Naxhis Sharani**

**Gjyqtari,**  
**Luan Berisha**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, gjykatës së apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.